


Protests at the Kavajë Stadium, 1990



SECTION

1970–1991

PERIOD

1990 - 1990

Media 1

MEDIA ITEMS #1

9

Merre F.OP.Gani Kurti

Dhene b.p." Mekaniku"

RA P O R T

T i r a n e ,me 31.3.1990

Burimi informon se me daten 31.3.1990, ai shkoi me sherbim ne Usinen e Goshde - Bullonave ne Kavaje per te diskutuar dhe nxitur prodhimet e kesaj ushine per export. Ne Kavaje burimi u shoqerua me Eduard Rusin, punonjes i Drejtorise se Pergjitheshme Mekanike ne Tirane dhe me drejtorin e tij. Sapo grupi arriti ne Usine,puntoret ishin mbledhur dhe diskutonin me Kryetarin e Bashkimeve Profesional te qytetit te Kavajes, me drejtuesit e ndermarjes etj. Gjate vizite me repartin e goshdeve, u mblodhen rreth nesh, puntoret te cilet shprehnin pakemqesi te ndryshme. Nder te tjere ata thonin : " A mbetet familja me nje pako gjalpe ne duar; perse behen diferencime midis qytetesh; perse eshte krijuar kjo gjendje ?". Ne takim me Sekretarin e Pate te Durrresit ,je u kemi ngritur keto probleme,por ai me u mburr se vete ka qene kergoier. Ata kerkonin urgjentisht qe te vije dhe te bisedoje gju me gju me ata nje anetar i Byroze Politike, me te kundert do te nise mi per ne Tirane ".

"Per keto gjendje ekonomike te krijuar, te vije dhe te jap llogari edhe i vdekuri dhe te ngrihet nga varri.

Shoferit te vetures, te Drejtorise Pergjitheshme Mekanike me mence, puntoret i kishin thene : " I paske mustaqet si te Stalinit. Hape buken qe shoferi kishte marre me vete, per te pare se ke me gjalpe dhe kur pane se shoferi kishte votem buke dhe pak djathe, ju drejtuan perseri duke i thene " qenke dora e jone".

Ne dalje te repartit te goshdeve, disa puntore thane " A e pate dhe e degjast zhurmen shurdhuese te makinave te vjetra.Ketu punojme qysh prej 25 vjet dhe nuk jetojme mire". Drejtori i Usines i tha se " kishte 3 dite pa shkuar ne shtepi, mbasi kishte frike se mos i hidhnin ne ere repartet ".

Burimi, pasi u nda nga Drejtori, i cili shkoi tek Sekre-

MEDIA ITEMS #2

10

- 2 -

tari i Pate i Mëjontit te Kavajes se bashku me kryetarin e B.Profesionale.

Ne vazhdim, puntoret i treguan burimit se ne ndeshjen midis "Beses dhe Partizanit" , sambistet e Tiranës, kane rraxhur per vdekje 2 puntore te Usines, dhe neqoftese ndonje prej tyre do te kishte vdekur, puntoret do t'a merrnin ne krahe dhe do te marshonin ne drejtim te Tiranës.

Burimi vuri re, se te gjithë puntoret e usines me te cilet ai bisedoi, ishin shume te indinjuar dhe flisnin pa ndrojtje duke kerkuar bisedime direkte me shoke te Byroze Politike.

Puntoret te mbledhur thane se ne qytetin e tyre jane shkruar edhe parrulla " Poshte Dinastia, vrote udhëheqesi kryesor i Partise " . Gjendje jone ekonomike eshte kutandisur keshtu nga Stalini dhe i vdekuri i jone. A kemi degjuar shperthime juve te Tiranës.? Burimi ritheksoi se puntoret e kesaj Usine dhe qytetaret e tjere te Kavajes rreth 10 - 15.000 vota, qendrojne te maskuar ne qytet dhe nuk guxon asnjeri qe t'u flape, qofte edhe nje polic, pasi jane gati te ngrihen ne demonstrate.

Shanilla e katyre ngjarjeve, sipas puntoreve , nisi ne ndeshjen e futbollit ku u perleshën me sambistet dhe populli kishte ngritur dy gishtat lart ne forme V-je ".

M E K A N I K U "

V L E R E S I M I : E dhena ka vlere operative,ne te del se puntoret e populli i qytetit te Kavajes eshte shume i revoltuar dhe nuk perjashtohet mundesia qe te ngrihet ne revolte kunder pushtetit.

D E T Y R A : Nuk ju dhene per keto gje b.p.

MASAT OPERATIVE: E dhena te shtypet menjehere ne 3 kopje per DFB Durrës, nje per Degen e Pate dhe nje per dosjen agjenturore.

Te vihet menjehere ne dijeni drejtuesit ne Drejtori.

Me telegram te njoftohet menjehere DFB Durrës dhe Ministri

PUNTORI OPERATIV

GANI KURTI

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT


No transcript is available for this media.

Media 2

MEDIA ITEMS #1



MEDIA ITEMS #2



INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.